



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I BASHKISË

GRAMSH

Nr. 037/2 prot

Gramsh, më 04.03.2021 /02/2021

Vendim

Nr. 16, dt. 26.02.2021

**Për miratimin e kërkesave në vazhdim për subvencionimin e interesave të kredisë me interes të ulët për familjet që kanë aplikuar pranë bashkisë Gramsh.**

Këshilli i bashkisë Gramsh, pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur nga drejtorja e shërbimeve publike dhe emergjenca civile “Për miratimin e kërkesave në vazhdim për subvencionimin e interesave të kredisë me interes të ulët për familjet që kanë aplikuar pranë bashkisë Gramsh”, bazuar në ligjin nr.22/2018, “Për strehimin social”, neni 73, të VKM nr.334, dt.12.06.2019 “Për përcaktimin e dokumentacionit për të përfutuar strehim sipas çdo programi social të strehimit dhe të afateve të procedurave të miratimit nga organet e vetëqeverisjes vendore”, të VKM nr. 453, dt.03.07.2019, “Për masën e subvencionimit të interesave të kredisë dhe procedurën e dhënies së tij për familjet që përfitojnë banesë me kosto të ulët me kredi të lehtësuara nga shteti”, si dhe të ligjit nr.139/2015, datë 17.12.2015, “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 8, pika 2;

**Vendos:**

- I. Të miratohen listat në vazhdim për subvencionimin e interesave të kredisë me interes të ulët për familjet që kanë aplikuar pranë bashkisë Gramsh si më poshtë:
  1. Familja e **z.Leonard Shaqir Murati** me përbërje familjare 5 vetë, struktura e apartamentit 2+1. kufiri maksimal i kredisë sipas përbërjes familjare 5 vetë dhe nivelit të të ardhurave neto mujore, të jetë **3 010 000** lekë.
  2. Familja e **z.Igli Haki Kola** me përbërje familjare 2 vetë, struktura e apartamentit 1+1. kufiri maksimal i kredisë sipas përbërjes familjare 2 vetë, dhe nivelit të të ardhurave neto mujore të jetë **2 580 000** lekë.
  3. Familja e **z.Denis Barjam Shkira** me përbërje familjare 3 vetë, struktura e apartamentit 1+1, niveli i kredisë sipas përbërjes familjare 2 vetë, dhe nivelit të të ardhurave neto mujore, të jetë **2 580 000** lekë.

- II. Të miratohet Lidhja 3-Formati i listës emërore.
- III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet kryetari i bashkisë dhe drejtoria e shërbimeve publike dhe emergjencave civile.
- IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Konc.Xh.Gjini

Miratoi:G.Lena

Dosja nr, \_\_\_\_\_

Afati \_\_\_\_\_

**Sekretari i Këshillit të Bashkisë**

**Xhulia GJINI**



**Kryetari i Këshillit të Bashkisë**

**Greta LENA**



**LIDHJA3 – Formati i listës emërore  
BASHKIA GRAMSH**

Nr.	Emri/Atësia/Mbiemri	Përbërja familjare	Struktura e apartamentit që përfiton	Kushtet e strehimit (neni 16, germa (a))	Kushtet familjare (neni 16, germa (b))	Kushtet sociale (neni 16, germa (c))	Të ardhurat mujore neto të familjes	Punësimi	Kufiri maksimal i kredisë që përfiton familja	Numri i kontaktit
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
1	Leonard Shagrir Murati	5	2+1	Nuk ka banese	Nuk ka Moshë e përgjithshme më pak se 60 vjet	Nuk ka	65046	Në shtet dhe vetëpunësim	3 010 000	0695529230
2	Igji Haki Kola	2	1+1	Nuk ka banese			56 541	Në shtet	2 580 000	0684449103
3	Denis Barjam Shkira	3	1+1	Nuk ka banese	Nuk ka	Nuk ka	85995	Në shtet	2 580 000	0696297494

Konc.Xh.Gjini

Miratoj G.Lena

Dosja nr. \_\_\_\_\_

Afati \_\_\_\_\_

Sekretari i Këshillit të Bashkisë

Xhulia GJINI

Kryetari i Këshillit të Bashkisë

Grëta LENA



*(Handwritten signature)*



Dr. Sherbimevo Publike  
Sek. Keshillit



BASHKIA GRAMSH  
NR. FETI 6373  
Mbërriti me Date 19.03.2021

19.03.2021

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
SEKTORI JURIDIK

Nr. 3/4 Prot.

Elbasan më 19.03.2021

Lënda: Mbi ligjshmërinë e aktit tuaj

**KËSHILLIT BASHKIAK GRAMSH**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr.107/2016 datë 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pas verifikimit të ligjshmërisë së aktit tuaj nr.16 datë 26.02.2021 “Për miratimin e kërkesave në vazhdim për subvencionimin e interesave të kredisë me interes të ulët për familjet që kanë aplikuar pranë Bashkisë Gramsh”, konfirmojmë në parim mbështetjen e tij në ligj, me përjashtim të pikës I/3, sipas argumenteve më poshtë:

Në mbështetje të nenit 48 pika 1 të ligjit nr.22/2018 “Për strehimin social” që një familje të përfitojë nga programi i banesave me kosto të ulët (BKU) duhet që të ketë të ardhura jo më të larta se të ardhurat mestare të njësisë të vetëqeverisjes vendore përkatëse, në këtë rast të Bashkisë Gramsh dhe kushtet e strehimit, sociale ose ekonomike, niveli i të ardhurave është kusht ligjor dhe i domosdoshëm.

Në aktin tuaj rezulton se një nga subjektet e përzgjedhur nga ju si përfitues përkatësisht z.Shkira ka të ardhura përtej kufirit maksimal të parashikuar në nenin 48 pika 1 dhe nenin 2 pika 45 shkronja a, e ligjit 22/2018 “Për strehimin social”.

Sjellim në vëmendjen tuaj që qëllimi i ligjit të posaçëm për strehimin social është krijimin e mundësive për strehim të përshtatshëm dhe të përballueshëm, duke u mbështetur në aftësitë paguese të familjeve që kanë nevojë për strehim. Që një subjekt të përfitojë nga një prej programeve sociale duhet që të përmbushë të paktën dy kushte komulative të mos ketë strehë ose banesa që ka në pronësi është nën normat e strehimit dhe niveli i të ardhurave të jetë brenda kufijve minimal dhe maksimal të përcaktuar nga ligji i posaçëm, pasi qëllimi i ligjit është që ti vij në ndihmë subjekteve që janë të pastrehë dhe njëkohësisht nuk kanë mundësi ekonomike për sigurimin e një banese me qira ose në pronësi në tregun e lirë.

Për sa më sipër pika I/3 e aktit tuaj nuk konfirmohet pasi është në kundërshtim me ligjin

REPUBLICA E SHQIPËRISË  
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN  
**PREFEKTI**  
Klevis Xhoxhi